



Planuar / Dorezuar Priljevoj/Prodato Received/Delivered	22.07.2022	2	viti god. year.
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDM810K	4266/2022		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.156/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1266/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.156/2020 të datës 03.06.2020 e parashtruar nga ankuesja me adresë banimi: nga Komuna e Kaçanikut, kundër organit të punësimit Komuna e Kaçanikut, në çështjen juridike "Ndërprerjeje e marrëdhënies së Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për Këshillim dhe votim me datë 21.07.2022, mori këtë.

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.156/2020 e datës 03.06.2020 e parashtruar nga ankuesja

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër 104/02-9821/20 i datës 29.05.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave si dhe Vendimi me numër protokoli 04 Nr. 104/02-8121/20 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Kaçanikut i datës 28.04.2020.

A r s y e t i m

Ndaj, Ankueses e cila sipas shkresave të lëndës është e punësuar në Komunën e Kaçanikut, udhëheqësi i saj i drejtpërdrejt, Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Kaçanikut, me datë 10.03.2020, me numër protokoli 04-104/02-8121/20 ka bërë kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore tek Udhëheqësja e Personelit në Komunën e Kaçanikut, ndërsa me datë 10.03.2020, për mes e- malit Udhëheqësja e Personelit në Komunën e Kaçanikut rastin e ka paraqitur tek Komisioni

Disiplinor i Komunës, ndërsa Komisioni Disiplinor i Komunës se Kaçanikut, me datën 28.04.2020 me numër protokoll 04 Nr.104/02-8121/20, ka nxjerr vendim me të cilin i ka shqiptuar ankueses masën disiplinore: *"Ndërprerjeje e marrëdhënies së punës pa e dëmtuar ose reduktuar të drejtën në pension"*.

Ankuesja [redacted] e pakënaqur me vendim e datës 28.04.2020 me numër protokoll 04 , Nr. 104/02-8121/20 të Komisionit Disiplinor me datën 18.05.2020, me numër protokoll 01/104/02-9821 me ankesë i është drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave tek Komuna e Kaçanikut, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës se Kaçanikut, me datën 29.05.2020 me numër protokoll 01Nr.104/02-9821/20 ka nxjerr vendim me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankueses [redacted] të datës 18.05.2020, duke e lenë në fuqi Vendimin me numër protokoll 04Nr.104/02-8121/20 të Komisionit Disiplinor të datës 28.04.2020.

Ankuesja [redacted] e pakënaqur me vendimin me nr. protokoll 01 Nr.104/02-9821/20 të datës 29.05.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës se Kaçanikut, me datën 03.06.2020 ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e cila është regjistruar me numër protokoll 1017/2020 me pretendimet ankimore se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankueses nuk mbështetet në dispozitat ligjore dhe i njëjti vendim është i një anshëm, ndërsa vendimi nga Komisioni Disiplinor është marrë jashtë afati pasi që shtyrja e afatit për vendimmarrje ka qenë kundërligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 05.06.2020, me numër protokoll 1036/2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Komuna e Kaçanikut , ndërsa me datën 12.06.2020 me numër protokoll 1153/2020, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Kaçanikut, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.07.2020, me numër protokoll 1315/2020, ka njoftuar ankuesen [redacted] se nuk mundë të shqyrton dhe vendose lidhur me ankesën A. Nr. 156/2020 të datës 03.06.2020 për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar ankuesin që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja [redacted] e pakënaqur me njoftimin e datës 06.07.2020, të Këshillit ka hapur konfliktin administrative, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 18.05.2022, A. Nr. 1266/2020 ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditëses me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 06.07.2020 duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A.nr.156/2020 të datës 03.06.2020 të ankueses

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 156/2020, e datës 03.06.2020, me numër protokoll 1017/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimit A. Nr. 1266/2020, të datës 18.05.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, Ankesa e datës 18.05.2020, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 28.04.2020, i Komisionit Disiplinor; Vendimi i datës 29.05.2020, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe

Ankesave; Kërkesë për shfuqizimin e vendimit të ndërprerjes së marrëdhënies së punës; Vendimi i datës 22.10.2020; Aktvendimi i datës 10.10.2019; i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Konkluzion i datës 11.03.2019, i Gjykatës Themelore në Ferizaj; letër rekomandim i datës 03.05.2019; Aktvendimi i datës 15.01.2019, i Gjykatës Themelore në Ferizaj; Aktgjykimi i datës 15.08.2018, i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Njoftimi i datës 12.05.2020; Deklaratë e datës 12.05.2020; kërkesa e datës 10.03.2020, për iniciimin e procedurës disiplinore; Vendimi i datës 06.03.2020 me numër prot:33/2020, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës; Vendimi i datës 06.03.2020, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me numër prot:34/2020; e- maili i datës 09.03.2020; e- maili i datës 10.03.2020; njoftimi i datës 10.03.2020; flete dorëzimi i datës 10.03.2020; e - mali i datës 16.04.2020;leje qarkullimi e datës 17.04.2020; Njoftimi i datës 06.07.2020, me numër protokoli 1315/2020, i Këshillit; Përgjigje në ankesë e datës 12.06.2020, me numër protokoli 1153/2020, Aktgjykimit A.nr.1266/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimin e Këshillit të datës 06.07.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja ka qenë e punësuar në Komunë e Kaçanikut në pozitën e punës "Drejtoreshë e Qendrës për Edukim dhe Arsim Parashkollor-QEAP Agimi", ndërsa udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë me datë 10.03.2020 ka paraqitur kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore, kurse Komisioni Disiplinor i Komunës së Kaçanikut përmes vendimit 04Nr.10/02-812/20 të datës 28.04.2020 i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore "Ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension".

Po ashtu, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 10.03.2022 ka gjetur se Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Kaçanikut njëherit udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses, kërkesën për iniciimin e ankueses me supozimin për shkelje të rënda të detyrave të punës e ka mbështetur nga veprimet e ndërmarra të ankueses e cila ua kishte shkëputur në mënyrë të njëanshme kontratat e punës dy (2) punëtoreve të "Qendrës për Edukim dhe Arsim Parashkollor -QEAP Agimi", respektivisht përmes vendimit me numër protokoli:33/2020 të datës 06.03.2022 i ishte ndërprerë marrëdhënien e punës

(kuzhinierë) dhe përmes vendimit me numër protokoli:34/2020 të datës 06.03.2020 i ishte ndërprerë marrëdhënien e punës (edukatore).

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstatoi se iniciimi i procedurës disiplinore është bërë në pajtueshmëri me nenin 12 paragrafi 1 të Rregullores Mr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: "Nëse udhëheqësi i drejtpërdrejtë konstaton se shkelja mund të cilësohet si shkelje e rëndë-serioze, në afat prej dy (2) ditë pune do ta paraqesë rastin me shkrim të udhëheqësi i njësisë së personelit" pasi që datat 7 dhe 8 mars 2020 rezultojnë të jenë ditë vikendi (e shtunë dhe e diel) ndërsa ankuesi me datë 09.03.2020 e kishte konsultuar ankuesen dhe me rastin e vlerësimit të tij se kemi të bëjmë me shkelje të rënda disiplinore rastin e ka paraqitur të Udhëheqësi i Njësisë së Personelit, njësi kjo e cila po ashtu kërkesën për iniciim të procedurës disiplinore e kishte paraqitur në të njëjtën datë me 10.03.2020 për shqyrtimin në Komisionin Disiplinor siç përcaktohet me nenin 12 paragrafi 2 Rregullores Mr.04/2011 për Procedurat

Disiplinore në Shërbimin Civil "Pas marrjes së njoftimit, udhëheqësi i njësisë së personelit, shkeljen e dyshuar ia kalon për shqyrtim komisionit disiplinor të institucionit përkatës" dhe po ashtu përmes e-mailit zyrtar njoftimi dhe ftesa i ish-in dërguar edhe ankueses me datë 10.03.2022 siç përcaktohet me nenin 12 paragrafi 3 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil "Udhëheqësi i Njësisë së Personelit, pas paraqitjes së rastit në komisionin disiplinor, e njofton me shkrim shkelësin e dyshuar brenda tri (3) ditë pune, ", pasi që ftesa përmban njoftimin me vendin dhe kohën e mbajtjes së seancës disiplinore, natyrën e shkeljes së dyshuar dhe mundësinë shoqërimin nga një person me të cilin mund të konsultoheni gjatë seancës.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji ka analizuar vendimet e datës 06.03.2020 me numër protokolli: 33/2020 dhe numër protokolli:34/2020 të datës 06.03.2020 përmes të cilëve ankuesja ua kishte ndërprerë marrëdhënien e punës dy (2) punëtorëve të Qendrës për Edukim dhe Arsim Parashkollor -QEAP Agimi dhe në bazë të arsytimit të dhënë si në vendimet e lartcekura nga ankuesja, e njëjta veprimin e saj e kishte bazuar në nenin 70 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës i cili rregullon kushtet dhe rrethanat e ndërprerjes e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit, mirëpo Kolegji vlerëson se ankuesja me rastin e ndërprerjes së kontratave të punës së dy punëtorëve të institucionit që e ka drejtuar ka dal jashtë kompetencave dhe detyrave të saj të punës ngase, në rastin konkrete punëdhënës i tyre ka qenë Drejtoria Komunale e Arsimit/Komuna e Kaçanikut e jo ankuesja.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka gjetur se Komisioni Disiplinor i Komunës së Kaçanikut me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe autorizimeve ligjore të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës neni 70 paragrafi 1 në paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 ku përcaktohet se: "Komisioni disiplinor ka këto kompetenca:1.1. të dëgjojë provat lidhur me shkeljen e supozuar; 1.2. të vendosë, në bazë të provave, nëse është kryer shkelja; dhe 1.3. përcakton dënimin që duhet shqiptuar." kishte tentuar disa herë të organizojë seancën dhe kjo tentativë provohet përmes e-mailit të datës 10.03.2020 dërguar nga Menaxherja e Njësisë së Burimeve Njerëzore, përmes e-mailit të datës 23.03.2020 dërguara nga Menaxherja e Njësisë së Burimeve Njerëzore, përmes e-mailit të datës 23.03.2020 dërguara nga Menaxherja e Njësisë së Burimeve Njerëzore, përmes njoftimit për paraqitje para Komisionit Disiplinor të datës 03.04.2020, përmes e-mailit të datës 03.04.2020 dërguara nga Menaxherja e Njësisë së Burimeve Njerëzore, mirëpo ankuesja nuk kishte marr pjesë në asnjë seancë të planifikuar përveç faktit që përmes e-mailit të datës 25.03.2020 i kishte njoftuar njërin se gjendet në pushim mjekësor, ndërsa Komisioni Disiplinor përmes vendimit të datës 08.04.2020 me numër 01-104/02-9061/20 në mbështetje të nenit 96 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Përveç kur ndalohet shprehimisht me ligji, nëse është e nevojshme për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative konkrete, organi publik mund të shtyjë, vetëm një herë, afatin fillestar të paraparë për përfundimin e procedurës administrative, sipas nenit 98 të këtij Ligji", andaj Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor i Komunës së Kaçanikut ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 98 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që afati i vendimmarrjes është shtyrë për më pak se afati kohor fillestar prej 30 ditësh siç është i përcaktuar me dispozitat e ligjit të veçantë, respektivisht nenit 14, paragrafi 3 i Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat disiplinore në Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se: "Faktet dhe dëshmitë për seancën disiplinore duhet të kompletohem sa më shpejtë që është e mundur dhe komisioni duhet të marrë vendim brenda tridhjetë (30) ditëve prej lajmërimit të rastit", respektivisht lënda ka qenë komplekse, shtuar faktin notor të

kohës së pandemisë Covid-019, andaj shtyrja e afatit vendimmarrës ka qenë e ligjshme, ndërsa pasi që Komisioni Disiplinor ia ka ofruar të gjitha mundësit për dhënien e qëndrimit të ankueses lidhur me iniciimin procedurës disiplinore, mos marrja pjesë e ankueses në seancën e organizuar nuk përbën parakusht për paligjshmëri të aktit të kontestuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës si dhe duke u mbështetur në të gjeturat dhe konstatimet e dhëna në këtë vendim, konstaton se Komisioni Disiplinor, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankueses *“ndërprerjeje e marrëdhënies së punës pa emetuar ose rekrutuar të drejtën në pension”*, ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës nën 70 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 ku përcaktohet se: *“Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.2. të vendosë, në bazë të provave, nëse është kryer shkelja; dhe 1.3. përcakton dënimin që duhet shqiptuar.”*, pasi që ankuesja me rastin e veprimeve të saja respektivisht ndërprerjes së marrëdhënies së punës së dy punëtorëve në institucionin të cilën e ka udhëhequr, ka dal jashtë kompetencave dhe autorizimeve të saja ligjore respektivisht ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës të përcaktuara si në nenin 6 paragrafi 1 në paragrafi 1.10, 1.6 dhe paragrafi 2 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil: *“Shkelje të rënda serioze, konsiderohen: 1.10 shkelja e detyrave të punës, që kanë pasojë për palën apo organin shtetëror; 1.16 sjellja apo kërcënimi që u pamundëson, i pengon apo ua vështirëson të tjerëve kryerjen me sukses të detyrave zyrtare të punës; 2. Mosrespektimi apo shkelja e parimeve dhe kushteve të sjelljes profesionale të nëpunësve civil të përcaktuara në kreun VII, respektivisht nenet 51 deri te 62 të ligjit”*, si dhe ka shkelur dispozitat e nenit 52 paragrafi të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës ku përcaktohet se: *“Nëpunësit civilë nuk do të bëjnë veprime apo të marrin vendime, të cilat i tejkalojnë kufijtë e rangut dhe funksioneve të tyre, përveç atyre të përcaktuara me këtë ligj”*, ndërsa masa e shqiptuar disiplinore është në pajtueshmëri me nenin 67 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 pika 1.2.4 ku përcaktohet se: *“Vetëm këto masa disiplinore mund të zbatohen për shkeljen e detyrave të përcaktuara me këtë ligj: 1.2. për shkelje të rëndë aplikohen masat disiplinore në vijim: 1.2.4. ndërprerja e marrëdhënies së punës në shërbimin civil nga komisioni disiplinor, pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension”*, pasi që ankuesja është përgjegjëse për shkeljen e konstatuar disiplinore siç përcaktohet edhe me nenin 63 dhe 64 në paragrafin 1 të tyre të njëjti ligj: *“Nëpunësit civilë do t’u nënshtrohen masave disiplinore për shkelje të detyrës, që ka ndodhur si rezultat i fajit të tyre, sikur që është përcaktuar me këtë ligj. Nëpunësit civilë janë përgjegjës për çfarëdo shkelje të parimeve të përcaktuara sipas këtij ligji”*, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara, ndërsa veprimet e institucionit janë në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuar të ligjit material.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Kaçanikut me rastin e nxjerrjes së Vendimi me numër 104/02-9821/20 i datës 29.05.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave përmes të cilët është refuzuar ankesa e ankueses, ndërsa ka lënë në fuqi Vendimin e datës 28.04.2020 me numër protokolli 04 Nr. 104/02-8121/20 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Kaçanikut, ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj, duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe të gjeturave të pasqyruar si në arsyetimin e këtij vendimin, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës, nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda me numër A.nr.156/2020

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Kaçanikut;
- Komisionit Disiplinor të Komunës së Kaçanikut;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kaçanikut;
- Znj. Gjqytare në Gjykatën Themelore në Prishtinë /Departamenti për Çështje Administrative
- Arkivit të KPMSHCK-së

